



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:162765

Datë: 19.03.2020

Numri i dokumentit: 00900931

P.nr.1018/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve E.Rr nga fshati ..., Komuna e Suharekës, dhe E.Z, nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.1035-14/2019 të datës 05.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Fatos Ajvazi, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre - avokat Y.K dhe avokat E.G, me datën 03.12.2019 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.E.RR, nga i ati B. dhe nëna M. e lindur B., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.E.Z, nga babai M. dhe nëna E. e lindur J., i lindur me datë në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga "...", nr.... ka të kryer shkollën e mesme, frizer, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I.I akuzuari E.RR,

I.Me datë 29.07.2018, rreth orës 12,30 minuta, në Qendrën Sportive "...", në Prizren, pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që gjatë një kontrole që është bërë nga Patrulla Policore me shifër të pandehurit E., në kuletën e tij i është gjetur një substancë bari e dyshuar për narkotik, e llojit marihuan me peshë të përgjithshme prej 0,41 gram,

Këso dore ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-ës.

II.I akuzuari E.Z,

II.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pikën I të dispozitiv të kësaj aktakuze, gjatë kontrollit që është zhvilluar nga policia, të pandehurit E.2 i gjejnë një qese najloni të vogël me bari e dyshuar për lëndë narkotike e llojit marihuan me peshë të përgjithshme prej 1,16 gram,

Këso dore ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 44, 46, 73, 74, 75, 275 par.2 të KP -së, të akuzuarit i shqipton:

Të akuzuarit të parë E.RR:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta pagoi në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro 1 (një) ditë burg, respektivisht 10 ditë burg,

Të akuzuarit të dytë E.Z:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 250 (dyqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta pagoi në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro 1 (një) ditë burg, respektivisht 12 ditë burg,

Po ashtu obligohen të akuzuarit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej 20,00 Euro, si dhe në emër të mbrojtjes të viktimave, po ashtu secili veç e veç shumë prej 30,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Konfiskohet bari i dyshuar për narkotikë i llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 0,41 gram dhe bari i dyshuar për narkotikë i llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 1,16 gram

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1035-14/2019 të datës 05.08.2019, kundër të akuzuarve E.Rr nga fshati ..., Komuna e Suharekës, dhe E.Z, nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të Kodit Penal të Kosovës (KPRK).

Gjithashtu Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, sipas aktakuzës PP.nr.1035-14/2019 të datës 05.08.2019, e në bazë të nenit 233 të KPP-ës, Prokurori

i shtetit dhe të akuzuarit E.RR, mbrojtësi i tij avokat Y.K dhe i akuzuari E.Z, mbrojtësi i tij avokat E.G, me datë 29.07.2019, kanë arrite marrëveshje për pranimin e fajësisë konform nenit 233 par.2 të KPP-ës.

Gjykata me datën 03.12.2019 ka caktuar dhe ka mbajtur seancën lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata konform nenit 233 ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ka dëgjuar Prokurorin e shtetit i cili ka përfaqësuar aktakuzën dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të akuzuarit në prezencën e mbrojtësve të tyre dhe ate për të akuzuarin E.RR, avokat Y.K, për të akuzuarin E.Z, avokat E.G, dhe ka vlerësuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve me mbrojtësit e tyre, ka vlerësuar se nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, marrëveshja është dokumentuar dhe në mënyrë të qartë e përpiluar, është nënshkruar nga Prokurori dhe mbrojtësit e të akuzuarve si dhe vet të akuzuarit, e po ashtu edhe nga ana e krye prokurorit, para fillimit të negociimit për pranimin e fajësisë prokurori, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre kanë pasur takim paraprake, nuk ka pasur pa rregullsi duke përfshirë ofertën që është iniciuar pranimi i fajësisë, palët janë pajtuar me të gjitha faktet dhe kushtet që i ka propozuar prokurori, të gjitha këto fakte janë të vërteta, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre nuk kanë pasur vërejtje apo mos pajtim lidhur me marrëveshjen, janë pajtuar në të gjitha pikat e marrëveshjes, në negociimin e marrëveshjes kanë qenë të përfshira të gjitha palët, palët nuk kanë asgjë të pa qartë, janë pajtuar me të gjitha kushtet në marrëveshje, palëve i ju është dhënë mundësia që të parashtrojnë pyetje, kanë pasur kohë të mjaftueshme për negociimin për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, kanë qenë të këshilluar lidhur me marrëveshjen të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim nga askush, të akuzuarit pranuan se ngjarja ka ndodhur ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, nuk kanë qenë ndonjëherë të mjekuar lidhur me problemet mentale ose emocionale nuk kanë përdorur ndonjë substancë apo medikament gjatë 24 orëve të fundit, dhe nuk kanë qenë dhe nuk kanë pasur nevojë të vizitohen te psikologu për shkaqe të depresionit, janë shëndosh dhe nuk kanë probleme shëndetësore. Të akuzuarit në vazhdim deklarojnë që nuk i ju është premtuar diçka dhe ndonjë shtesë dhe nuk kanë ndonjë marrëveshje me dikende tjetër që ta pranojnë fajësinë, e po ashtu nuk kanë qenë ata personalisht apo ndonjë anëtar i familjes të kërcënuar nga policia apo nga dikush tjetër për pranimin e fajësisë, si dhe nuk janë paguar nga dikush me të holla në mënyrë që të ndikojnë në pranimin e fajësisë.

Po ashtu të akuzuarve i ju është tërhequr vërejtja dhe janë njoftuar se pranimi i fajësisë paraqet ofertën nga gjykata dhe prokuroria që me anë të pranimin të fajësisë nuk do të administrohen provat e propozuara, aktgjykimi i tillë nuk mund të atakohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, prokuroria heqë dorë që të thërras dëshmitarë, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre heqin dorë për të marr në pyetje dëshmitarët, të dëmtuarit apo bashkë ekzekutorët si dhe dëshmitarët që janë në favor të tyre.

Po ashtu të akuzuarit janë njoftuar që nëse gjykata pranon fajësinë, e njëjta nuk mund të tërhiqet më vonë, dhe nëse ju shqipton dënim të marrëveshjes do të jetë shumë vështirë nga ana e të njëjtëve të sfidohet shqiptimi i dënimit,

Në fund të akuzuarit deklaruan që kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe se pranojnë fajësinë si në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të datës 29.07.2019.

Prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën PP.nr.1035-14/2019 të datës 05.08.2019 dhe pas leximit shkurtimisht ka elaboruar marrëveshjen për pranim të fajësisë të lidhur në mes të Prokurorisë dhe të akuzuarve E.Rr dhe E.Z, për shkak të veprës penale në posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Kosovës (KPRK), me të cilën marrëveshje është propozuar dënimi dhe ate për të akuzuarin E.RR, dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, si dhe për të akuzuarin E.Z, dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro, të cilën shumë të akuzuarit janë të obliguar ta pagojnë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro 1 (një) ditë burg,

Gjykata ka vlerësuar se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret e të cilat janë paraqitur në aktakuzë dhe në provat materiale të paraqitura nga Prokurori të pranuar nga i akuzuari si dhe nga dëshmi tjera të paraqitura nga Prokurori.

Gjykata është e bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18 të nenit 233 të KPP-ës, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në shqyrtimin për marrëveshje të pranimit të fajësisë të akuzuarve ju ka shqiptuar dënimet dhe ate të akuzuarit E.RR, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Kosovës (KPRK), dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, si dhe për të akuzuarin E.Z, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Kosovës (KPRK), dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro,

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi konfiskimin e sendit gjykata e bazoi në kuptim të nenit 115 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1018/2019 me datë 03.12.2019

Procesmbajtësja
Nacis Sarani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate